

RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN  
“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN  
E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT 2019 - 2023 DHE PLANIN E  
VEPRIMIT”

I. QËLLIMI I PROJEKT-VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË  
SYNOHEN TË ARRIHEN.

Projektvendimi i propozuar, ka si qëllim miratimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit, i cili është përgatitur në vijim të dokumentit të Strategjisë Sektoriale të Turizmit 2007 – 2013, që e përfundoi shtrirjen kohore të tij në vitin 2013, si dhe në funksion të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, pjesë e së cilës është edhe industria e turizmit.

Drafti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit u realizua me konsulencën e ekspertëve të Organizatës Gjermane për Bashkëpunim Teknik në Shqipëri (GIZ) dhe specialistë të turizmit pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit duke u konsultuar me grupet e interesit.

Synimi që Shqipëria të identifikohet e të njihet si një destinacion turistik tërheqës, autentik dhe mikpritës në rajonin e Mesdheut dhe Evropë do të bazohet në zhvillimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike të vendit, duke kontribuar në rritjen e mirëqënies sociale, rritjen e punësimit, krijimin e një mjedisi mundësues për sipërmarrësit vendas, tërheqës për investimet e huaja dhe rritjen e konkurrencës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA  
POLITIKE.

Projektvendimi për miratimin e këtij dokumenti është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave si dhe është parashikuar në Programin analitik të akteve (për vitin 2019) miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2022, parashikon zhvillimin e turizmit si një proces të qëndrueshëm ku objektivi ekonomik duhet balancuar me mbrojtjen e mjedisit, kulturës dhe mirëqënies së komunitetit.

Gjithashtu parashikohet që ky zhvillim të jetë i planifikuar, me synimin për të siguruar cilësi dhe prioritet, të orientuar nga tregu dhe standardet.

Dokumenti strategjik parashikon zhvillimin dhe diversifikimin e produkteve turistike, zhvillimin e destinacioneve dhe menaxhimin e tyre, duke zgjeruar spektrin e vizitorëve dhe kthimin e turizmit nga sezonal në turizëm gjithëvjetor.

Për realizimin e qëllimeve të sipërcituara, është hartuar i detajuar, plani i veprimit të strategjisë me aktivitetet përkatëse.

### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektvendimi propozohet duke u mbështetur në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 9, të Ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, në të cilën përcaktohet detyrimi i ministrisë përgjegjëse për turizmin për hartimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit të saj.

Strategjia mbështetet tek elementët kryesorë pozitivë të strategjive të mëparshme për turizmin, legjislacionin ekzistues për turizmin, si dhe një sërë dokumentesh të rëndësishëm ndërkombëtare.

Konkretisht, për sa i takon analizës dhe kornizës së përgjithshme të veprimeve ajo mbështetet tek Strategjia e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 844, datë 11.06.2008 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të turizmit, për periudhën 2007 - 2013 ”.

Hartimi i kësaj strategjie është realizuar duke u mbështetur në objektivat strategjike për zhvillimin e turizmit përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 dhe harmonizuar me Strategjinë për Zhvillimin e Evropës Juglindore (SEE 2020), hartuar nga Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal (RCC). Po kështu, çështjet e planifikimit, industrisë turistike dhe standardeve mbështeten tek parimet e legjislacionit ekzistues për turizmin. Për sa i takon masave zbatuese të politikave, janë marrë në konsideratë përvoja pozitive nga vendet e OECD-së etj.

#### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit dhe me acquis communautaire.

#### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në pjesën e parë të dokumentit jepet një analizë e detajuar e zhvillimeve në sektorin e turizmit në Shqipëri, duke dhënë edhe krahasimet përkatëse mbi situatën dhe tendencat e tregjeve ndërkombëtare. Vlerësimi i situatës është lidhur kryesisht me:

- Produktet turistike
- Atraksionet
- Infrastruktura turistike
- Kapacitetet akomoduese, agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë

- Rëndësia e Sektorit të Turizmit në Ekonominë e Shqipërisë
- Burimet njerëzore për turizmin
- Shqipëria në kontekstin rajonal

Për hartimin e pjesës analitike u shfrytëzua një numër i madh burimesh, të cilat përfshinin të dhëna të ndryshme, studime, publikime etj, të publikuara nga organizata shqiptare dhe ndërkombëtare. Ndër to, përfshihen të dhëna nga INSTAT, Banka e Shqipërisë, Këshilli Botëror i Udhëtimeve dhe Turizmit (WTTC), raporti mbi Tourism Satellite Account në Shqipëri (SNV), Publikimet e OBT mbi tendencat dhe zhvillimet e tregut&produktit (UNWTO), OECD – Tendencat e tregut dhe politikat, studime të GIZ, etj.

Me tej janë përfshirë një numër i konsiderueshëm treguesish sasiorë dhe cilësorë, që lidhen kryesisht me numrin e vizitorëve të huaj në Shqipëri gjatë viteve të fundit, kontributin e turizmit në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) dhe punësimin, shpenzimet e turistëve në Shqipëri, numrin e vizitorëve në atraksionet kulturore të vendit, shërbimet e akomodimit etj. Këta tregues e bëjnë më të prekshme dhe më të qartë situatën e zhvillimeve të sektorit të turizmit në Shqipëri, si për sa i takon kërkesës, ashtu edhe ofertës.

Pjesa e dytë e draft-strategjisë fillon me përcaktimin e vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike. Ajo përcakton si vizion duke deklaruar:

“Shqipërinë si një destinacion mikpritës, tërheqës, autentik për zhvillimin e potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit”.

Për realizimin e vizionit të mësipërm, janë identifikuar katër qëllime strategjike, të cilat njëherazi do të jenë edhe gurët e themelit të këtij dokumenti:

1. Krijimi i poleve dhe industrive të reja të zhvillimit si dhe konsolidimi i ofertës turistike dhe krijimi i produkteve të reja;
2. Rritja e vlerës së shtuar dhe e impaktit të sektorit në ekonomi dhe punësim;
3. Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i cilësisë së tyre;

4. Përmirësimi i imazhit të vendit dhe promovimi i produkteve autentike lokale;

Më tej në dokument për të përmbushur realizimin e qëllimeve strategjike të sipërpërmendura, janë përcaktuar pesë prioritetet strategjike kryesore si më poshtë:

- Prioriteti Strategjik 1: Nxitja e Investimeve Publike dhe Private;
- Prioriteti Strategjik 2: Konsolidimi dhe Zhvillimi i Produkteve Turistike;
- Prioriteti Strategjik 3: Përmirësimi i Shërbimeve Turistike;
- Prioriteti Strategjik 4: Ri-orientimi i Promovimit drejt Potencialeve;
- Prioriteti Strategjik 5: Mbështetje për Menaxhimin e Destinacioneve.

Për secilin prioritet strategjik janë përcaktuar nga tre masa, që të aplikuar bashkërisht, do të çojnë në realizimin e secilit objektiv.

Objektivat e përcaktuar në këtë strategji lidhen kryesisht me ofertën e akomodimit, gamën e shërbimeve dhe përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së tyre, zhvillimin e destinacioneve, nivelin e punësimit, rritjen e investimeve në turizëm, rritjen e turizmit hyrës (incoming) etj.

Kapitulli i Burimeve financiare, paraqet kornizën për financimin e strategjisë. Identifikimi i burimeve potenciale vendase dhe të huaja, lehtësimi i rritjes së investimeve private vendase dhe të huaja, rritja e aftësisë absorbuese të financimeve nga BE dhe cdo burim bilateral, rritja e cilësisë së përzgjedhjes dhe implementimit të projekteve me efekt multiplikator sa më të madh, përbëjnë prioritetin kryesor të lidhjes më të mirë realiste të objektivave konkrete me burimet potenciale financiare.

Ndëkohë kapitulli “Zbatimi dhe Monitorimi” është pjesë e rëndësishme e strategjisë, pasi ai siguron zbatimin e rregullt të saj. Përcaktimi i treguesve, afatit kohor dhe përgjegjësive janë drejtimet kryesore për krijimin e kornizës së llogaridhënies. Objektivat janë paraqitur në formë tabelare në Matricën e Vletrësimit të Performancës, ku janë përfshirë treguesit, periudha kohore, institucionet që do të masin nivelin e arritjes së treguesve, si dhe institucionin kryesor përgjegjës për monitorimin.

Bashkëngjitur Strategjisë ndodhet Plani i Veprimit i Dokumentit Strategjik, në të cilin përfshihen të gjithë fushat kryesore dhe masat strategjike për çdo fushë. Aty përfshihen afatet përkatëse për realizimin e masave, burimet financiare, strukturat përgjegjëse për realizimin e tyre, treguesit e matshëm, si dhe nevojat e mundshme për projekte.

Draft strategjia e zhvillimit të turizmit 2019 - 2023 është një dokument që do të orientojë jo vetëm zbatimin e politikave turistike, por edhe Projekt-Buxhetin-Afatmesëm për turizmin deri në vitin 2023.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI.

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT.

Për hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit, Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis.

### **Procesi i konsultimit të draft Strategjisë me palët e interesuara**

Dokumenti i draft Strategjisë është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Gjithashtu, drafti është konsultuar me palët e interesit, si dhe ka kaluar në diskutim me përfaqësuesit e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, përfaqësuesit e subjekteve

që ushtrojnë veprimtari turistike dhe me organizatat ndërkombëtare në Shqipëri që bashkëpunojnë në fushën e turizmit, sipas kalendarit të mëposhtëm:

- a) Takim i zhvilluar në datën 23 Shkurt 2018, me 25 përfaqësues të agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë;
- b) Takim i zhvilluar në datën 26 Shkurt 2018, me 23 përfaqësues të institucioneve të ndryshme publike e private dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri;
- c) Takim i zhvilluar në datën 27 Shkurt 2018, me 68 përfaqësues të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, përfaqësues të sipërmarrjeve turistike;
- d) Takim i zhvilluar në datën 01 Mars 2018, me 33 përfaqësues të institucioneve Akademike, OJF, Shoqëri Civile;
- e) Takim i zhvilluar në datën 08 Mars 2018, me 18 profesorë dhe 25 studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës.

Ky projektakt do të nënshtrohet procesit të konsultimit me ministritë e linjës si Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtëme, Ministrit të Shtetit dhe Diasporës, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Kostoja për realizimin e planit të veprimit të kësaj Strategjie është e bazuar kryesisht në Programet e Buxhetit Afatmesëm për periudhën 2019-2021 dhe parashikimet për vitet 2022-2023.

Buxheti i përgjithshëm i planit të veprimit të strategjisë është sipas tabelës më poshtë:

Kosto totale (000 lekë)	Financimi brendshëm (000 lekë)	Financimi huaj (000 lekë)	Hendeku (000 lekë)
1,829,840.00	1,424,146.00	221,473.60	184,220.40

Në lidhje me hendekun e krijuar ndërmjet koston totale të aktiviteteve të planifikuara dhe financimit nga buxheti, mendohet të kërkohet mbështetje nga donatorë.

Në rast se nuk do të arrihet sigurimi i fondeve të nevojshme, do të vijohet me realizimin e pjesshëm në varësi të buxhetit të siguruar.

Konkretisht:

Është parashikuar organizimi i tetë konferencave për tërheqjen e investitorëve për të cilat buxheti në dispozicion mbulon vetëm katër prej tyre. Realizimi i katër konferencave të tjera do të jetë në varësi të sigurimit të buxhetit shtesë.

MINISTËR  
BLENDI KLOSI